VENDIM
Nr. 489, datë 21.7.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), BASHKIA KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE

(Ndryshuar me VKM nr. 829, datë 26.12.2024; nr. 755, datë 19.12.2025)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, në masën 325 219 895 (treqind e njëzet e pesë milionë e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimin e pallatit nr. 5, në masën 166 576 136 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimin e pallatit nr. 6, në masën 158 643 759 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi, në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 65 043 979 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e dyzet e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

2/1. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 132 025 098 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e njëzet e pesë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.

2/2. Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2025, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 124 043 103 (njëqind e njëzet e katër milionë e dyzet e tre mijë e njëqind e tre) lekë pa TVSH, për rindërtimin në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025.

3. Caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit në truallin ekzistues të 2 (dy) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin, *sipas pikave 1, 2, dhe 2/1* të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama